REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 45/17
Datë/Datum. 22.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH Nr. 45/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z. Blerim Dina - Kryetar, z. Ekrem Salihu - Referues, z. Nuhi Paçarizi - Anëtar, z.Goran Milenković – Anëtar, z.Tefik Sylejmani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga konsorciumi ankues "Pastor Kosova Shpk & Professional Alarm" - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me aparate kundër zjarrit, Instalimi dhe shqyrtimi i sistemeve aktuale për shuarjen e zjarrit", me nr prok: "16/005/111", iniciuar nga autoriteti kontraktues /Korporata Energjetike e Kosovës/, më datën 15.03.2017 mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet,** pjesërisht si e bazuar ankesa e konsorciumit ankues "Pastor Kosova Shpk & Professional Alarm" - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me aparate kundër zjarrit, Instalimi dhe shqyrtimi i sistemeve aktuale për shuarjen e zjarrit", me nr prok: "16/005/111", iniciuar nga autoriteti kontraktues /Korporata Energjetike e Kosovës/.

II. **Vërtetohet,** vendimi për dhënie të kontratës i AK-së /Korporata Energjetike e Kosovës/, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me aparate kundër zjarrit, Instalimi dhe shqyrtimi i sistemeve aktuale për shuarjen e zjarrit", me nr prok: "16/005/111".

III. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh, duhet ta informojë me shkrim Panelin shqyrtues, për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe palët tjera në procedurë.

IV. Konsorciumit ankues "Pastor Kosova Shpk & Professional Alarm" - Prishtinë, i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumë e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, pasi që pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara.

V. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 36 pika 5 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:12.08.2016.

Hapja e ofertave është bërë me dt: 26.09.2016, ku kanë marr pjesë dy (2) operatorë ekonomik.

Letra standarde për tenderuesin e pasuksesshëm është dërguar me datën 04.01.2017.

Njoftimi për dhënie të kontratës është bërë me dt: 27.12.2016, e ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "ALBKOS INTERNATIONAL-EUROTRADE" - Fushë Kosovë.

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës, konsorciumi "Pastor Kosova Shpk & Professional Alarm" - Prishtinë, me dt:10.01.2017, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt:07.02.2017, autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Pastor Kosova Shpk & Professional Alarm" - Prishtinë.

Konsorciumi ankues "Pastor Kosova Shpk & Professional Alarm" - Prishtinë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, më 14 shkurt 2017 me nr. 45/17, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me aparate kundër zjarrit, Instalimi dhe shqyrtimi i sistemeve aktuale për shuarjen e zjarrit", me nr prok: "16/005/111", duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni i LPP-së –(Qëllimi)
- Neni 6 i LPP-së –(Ekonomiciteti dhe efikasiteti)

- Neni 7 i LPP-së-(Barazia në trajtim/jo diskriminim)
- Neni 9 i LPP-së -(Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur)
- Neni 28 i LPP-së-(Specifikimet teknike)
- Neni 51 i LPP-së-(Njoftimi i kritereve të zgjedhjes)
- Neni 53 i LPP-së-(Sigurimi i informatave shtesë për kandidatet dhe tenderuesit)
- Neni 59 i LPP-së-(Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve)
- Neni 60 i LPP-së-(Kriteret e dhënies së kontratës)
- Neni 72 i LPP-së-(Dokumentacioni dhe informacioni shtesë)

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues/teknik përmes raportit të datës 10 mars 2017, e ka vlerësuar të pa bazuar ankesën e OE Pastor Kosova & Alarm Professional", prandaj eksperti teknik në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon që autoriteti kontraktues KEK, të vazhdojë me dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me aparat kundër zjarrit, instalimi dhe shqyrtimi i sistemeve aktuale për shuarjen e zjarrit" me nr prok: "16/005/111" në përputhje me dispozitat e LPP-së.

Konsorciumi ankues "Pastor Kosova Shpk & Professional Alarm" - Prishtinë, me datë: 03 mars 2017, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti kontraktues, me datë 03 mars 2017 me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 15.03.2017, ku kanë qenë prezent anëtarët e panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, vëzhgues nga OJQ "D PLUS", ku u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për dhënie të kontratës,procesverbalin e hapjes së ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues ka deklaruar: "Kam lexuar raportin e ekspertit dhe është komplet kopje e vendimit të AK, edhe pse kemi pritur se do jap detaje më shumë. "Kur kam kërkuar qasje në dokumente, e është ofruar dosja e OE të rekomanduar dhe pak a shumë kam pas një orientim ku kemi menduar se ka shkelje, dhe ashtu kam vërtetuar, ku kemi detajizuar shkeljet e rënda. Pesë apo gjashtë pika kanë të bëjnë me pozicion 3 të dosjes, ku është

kërkuar aparat special për zjarrfikje ku i vetmi prodhues në botë është Britania Fire LTD. Ne kemi parë një certifikatë që ka ofruar OE i rekomanduar ku katër pozicionet e fundit janë parashtresat Brit, dmth të ati prodhuesi që cekëm më lart. Kemi kërkuar sqarime nga instituti anglez që ka dhënë certifikatën, dhe kanë thënë se katër pozicionet e fundit i kemi fshirë nga certifikata e Mobiak pasi nuk janë të certifikata prej neve. Pjesë e këtyre katër pozicioneve është edhe pozicioni nr.3. Në kontekst të kësaj OE i rekomanduar për kontratë nuk ka autorizim, katalog, certifikatë kualiteti etj nga prodhuesi Britania Fire LTD. Për pozicionet 7 deri1 dhe 14 deri 27. OE i rekomanduar për kontratë në rubrikën prejardhja mallrave ka cek se pozicionet 13 deri 16 janë produkte të Mobiak. Sa për informim këto pozicione janë sisteme automatike për fikje dhe nuk kanë të bëjnë me aparat të zjarrit dhe duhet me qenë me standard të veçantë. Në ofertën tonë janë diku 15 faqe që përfshijnë gjitha për pozicionet 13 deri 17, dhe ka mund të krahasoj certifikatat tona në ofertë, ndërsa Mobiak nuk prodhon sisteme të tilla. Në anën tjetër OE i rekomanduar ka ofruar kryesisht produkte Kineze, janë certifikatat të prodhuesve kinez dhe nuk janë Mobiak. Sa i përket ofertës tonë AK ka cek se gjoja kemi ndërhy te përshkrimi i dosjes së tenderit. Ne kemi këtu me vete dosjen dhe vetmi dallim është që kur kemi bërë kopjen e dosjes tri faqe janë përsëritur, dhe nuk ka ndryshim tjetër. Po ashtu një kontest ka qenë për një pajisje kontrolli panelit për pozicionet 13 deri 16, i cili kontroll panel e dirigjon gjithë sistemin për fikje të zjarrit është lloj memorie. Ne ofertën që kemi bërë kemi bërë në përputhje me kushtet kërkuara në dosje te tenderit, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar ashtu si është kërkuar në dosje, sepse kontrolli i panelit ka mundësinë e lidhjes vetëm për alarmim të zjarrit, detektor dhe sirenën, mirëpo jo edhe për lidhje të sistemit për fikje të zjarrit. Kjo është një lajthitje pasi kërkojnë diçka tjetër dhe pranojnë diçka tjerr sa për na larguar nga gara. Për ne këto janë shkelje të rënda.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-KEK ka deklaruar: "Sa i përket pozicionit 3 që deklarohet pala ankuese, nuk qëndron arsyetimi i tij për shkak se gjatë rishqyrtimit të ankesës të parashtruar nga pala e eliminuar ne kemi bërë verifikimin e autorizimit, dhe certifikatës, ashtu që të gjithë çka janë të involvuar janë kopjuar, duke përfshirë Mobiak, Britania Fire LTD dhe kompaninë e cila bënë lëshimin e certifikatave BSI. Si pikënisje këtyre parashtrimit t pyetjeve ka qenë dërgimi i palës ankues të një emaili qoi është drejtuar kompanisë për certifikim. Ne kemi vërtetuar certifikatën dhe kompania certifikuese ka konfirmuar se Mobiak është i certifikuar në bazë të standardit EN3, çka është edhe pjesë e ofertës. Standardi EN 3 përfshinë edhe këtë produkt. Ndërsa përgjigjen e kemi marr po ashtu nga Prodhuesi Britani Fire LTD që përveç neve këtë produkt e prodhojnë edhe disa kompani tjera, këtë përgjigje e gjeni në shkresat e lëndës. Po ashtu në kërkesën e bashkangjitur për rishqyrtim gjendet edhe përgjigja që palës ankuese ia ka konfirmuar prodhuesi britanez se ja tërheq autorizimin. AK-KEK i ka shfrytëzua gjitha mundësitë për verifikimin e dokumenteve prej autorizimit deri të certifikata kualitetit. OE ankues edhe me rastin e dytë , ka ofruar ofertën e njëjtë si herën e parë, ndërsa ne me rastin e ritenderimit kemi bërë ndryshim të specifikave teknike. Un kam qenë pjesë e komisionit, dhe paqartat që ceken për pozicionet 13-17 e i kemi të në divizionin e qymyrit në 11 pozicione, janë të instaluar dh funksionojnë sot. Ju njoftoj me bateritë, pasi janë 2 më shumë afrata, peshojnë 40 kg ose 67.5litra, është paneli i cili funksionon dhe ka gjashtë zona , identifikon zjarrin që shfaqet në gjashtë zona, ndërsa ne i kemi të lidhur në dy zona. OE i rekomanduar është teknikisht i përgjegjshëm pasi ka ofruar certifikatë sipas kërkesës së AK-së. Sipas specifikimit teknik edhe OE i ka ofruar sipas kërkesës së AK-së. Sa i

përket deklaratës së OE ankues për certifikata, OE i rekomanduar ka ofrua certifikatat sipas standardit EN3.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues ka deklaruar: "Gjatë shqyrtimit dhe analizës, pretendimet e ngritura nga OE ankues, jam munduar të jap përgjigje për secilin pretendim ankimor , duke krahasuar kërkesat e dosjes së AK dhe ofertën që ka dhënë OE i rekomanduar për kontratë. Për gjitha pikat e ngritura ankimore nga OE ankues gjatë analizës nuk kam mund të gjejë asnjë arsyetim me cilat kisha mund të vërtetoj pretendimet e OE ankues. Specifikimi teknik i ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë krahasuar me pjesën e AK, dhe në ofertë është paraqitur përshkrimi teknik i pajisjeve që kanë dhënë OE i rekomanduar janë pothuajse 100% të njëjta. Për gjitha pozicionet e shtruara në pretendime ankimore janë bërë këto krahasime nga ana ime, në përshkrimin teknik të dosjes. Qëndroj në përgjithësi në raportin e ekspertizës dhe nuk kam çka të shtoj më shumë për këto që u ngritën gjatë seancës së sotme".

Gjatë vazhdimit në seancë Anëtari i panelit shqyrtues z.Sylejmani pyeti përfaqësuesin e AK-së lidhur me pozicionin 3 për 4 artikujt e fundit, se Mobiak a plotëson këto pika edhe a është prodhues i këtyre produkteve?

Në përgjigje përfaqësuesi i AK-së ka deklaruar: "OE ka ofruar ofertën teknike ashtu siç kemi kërkuar, ndërsa për certifikatë kemi përgjigje ku deklaron se përveç që prodhon vet, prodhohet edhe nga disa kompani tjera. Mobiak është kompani në Greqi mirëpo ka përfaqësues edhe nëpër vende tjerra në Evrope dhe sipas dosjes është prodhues, për prodhim dhe mbushje.

Në reagim eksperti shqyrtues/teknik ka deklaruar: "Në kuadër të produkteve të veta Mobiak në ueb faqe ka pikërisht aparatin që është kërkuar nga AK".

Anëtari i panelit shqyrtues z.Sylejmani pyeti përfaqësuesin e AK-së se OE i rekomanduar për kontratë a ka ofruar me prodhime edhe të prodhuesve tjerë - kinez siç pretendon OE ankues?

Në përgjigje përfaqësuesi i AK-së, deklaruar:"Ne sa kemi mund të vërejmë gjitha prodhimet janë të Mobiak, Olimpia Electronics".

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues ka deklaruar:"I propozojmë panelit shqyrtues që të aprovoj ankesën tonë si të bazuar dhe të shpallet i papërgjegjshëm OE i rekomanduar për kontratë dhe lënda të kthehet në Rivlerësim".

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së ka deklaruar: "Herën e parë kjo lëndë ka qenë në rivlerësim, nga hera parë është eliminuar OE dhe në atë kohë nuk ka bërë ankesë në eliminimin e tij. Ankesën e parë për rivlerësim e ka bërë OE tani i shpallur fitues. Qëndrojmë pranë vendimit të AK dhe i propozojmë panelit shqyrtues të njëjtin ta vërtetoj si të bazuar duke refuzuar aneksen e OE ankues.

Në fjalën përfundimtare eksperti shqyrtues/teknik ka deklaruar: "Qëndroj në tërësi pranë raportit të ekspertizës dhe konstatimeve e rekomandimeve të dhëna në ekspertizë.

Lidhur me pretendimet e OE ankues se prodhuesi Mobiak nuk e prodhon pajisjen e kërkuar në pikën 1 pozicionin 3 ku është kërkuar një aparat special për zjarrfikje me 60 kg pluhur ABC 40%, dhe se këtë pajisje e ofron vetëm një prodhues në botë "Britania Fire LTD", paneli shqyrtues konstaton se nuk qëndron pretendimi ankimor me faktin se OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij ka ofruar të dhënat teknike për aparatin në fjalë, të cilat i përgjigjen kërkesës së dosjes së tenderit dhe për këtë ka ofruar edhe certifikatën e cilësisë me nrKM 594785 nga prodhuesi Mobiak. Gjithashtu OE i rekomanduar ka ofruar këtë tip të aparatit (MBK09250PA-H1B) i cili është i prodhuar dhe certifikuar me standardin CE, EN 1866 ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar autorizim, katalog dhe certifikatë kualiteti nga prodhuesi, paneli shqyrtues konstaton se në ofertën e konsorciumit të rekomanduar për kontratë ekziston autorizimi valid, ISO certifikata, katalogu me prospekte dhe përshkrime të qarta teknike për produktin në fjalë i lëshuar nga prodhuesi, prandaj paneli shqyrtues konstaton se ky pretendim nuk është i qëndrueshëm.

Gjithashtu është i paqëndrueshëm edhe pretendimi i OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar deklaratë garancioni nga prodhuesi Britania fire ltd, pasi që OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar deklaratë nga prodhuesi me të cilin ka ofertuar dhe se kjo deklaratë është në përputhje me dosjen e tenderit.

Sa i përket pretendimeve të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka panelin e kontrollit sipas specifikave teknike të kërkuara për "Mbrojtjen nga zjarri në konvejer të ri", paneli shqyrtues konstaton se në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë shihet se është dhënë Panel kontrolli (Bs-636) dhe përshkrimi teknik i prezantuar në ofertën e fituesit ku shihet se janë plotësuar kriteret teknike të kërkuara

Gjithashtu është i paqëndrueshëm pretendimi i OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar specifikime teknike në përputhje me kërkesat e AK-së për "Mbrojtjen nga zjarri në konvejer të vjetër" konkretisht është i paqëndrueshëm pretendimi që paneli i kontrollit i ofruar nga OE fituese nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit. Paneli shqyrtues konstaton se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar panel të kontrollit 6 zonësh (BS-636) që do të përdoret për të tre vendet dhe secili vend paraqet zonë të veçant dhe të pa varur nga njëra tjetra.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se OE ankues është shpallur i papërgjegjshëm nga autoriteti kontraktues, pasi që ofertën teknike nuk e ka ofruar sipas dosjes së tenderit. OE ankues ka ofertuar me ofertë teknike që është kërkuar herën e parë e jo sipas kërkesave dhe ndryshimeve që janë bërë me rastin e ritenderimit të këtij aktiviteti të prokurimit, sikurse edhe po te ishte shpallur i pergjegjeshem ky OE nga ana e AK-se prak nuk do te mund te shpërblehej me kontrate pasi qe ka ofruar çmim më të lartë se OE i rekomanduar për kontratë përafërsisht në vlerë prej 43,000.00 €.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se autoriteti kontraktues e ka respektuar nenin 59 të LPP-së me rastin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Njëkohësisht është

respektuar edhe nenin 60 i LPP-së, respektivisht kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "Korporata Energjetike e Kosovës"

1x1 OE – "Pastor Kosova Shpk & Professional Alarm" - Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në ëeb- faqe të OSHP-së.